

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI

I KURSIT TË UNIFIKUAR

SHËRBIME NË BLETARI

Kodi: PK-H-3-22

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“SHËRBIME NË BLETARI”

(PK-H-3-22)

I. Profili profesional i bletërritësit

a) Karakteristikat e bletërritësit

Bletërritësit janë të aftë të kryejnë detyra profesionale si të punësuar apo të vetëpunësuar në sektorin e përgatitjes së bazës materiale, në sektorin e përgatitjes së ushqimeve për bletarinë dhe për trajtimin me medikamente të ndryshme që përdoren në apikulturë.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, bletari, duhet që të zotërojë njohuri dhe shprehje profesionale që lidhen me veprimtarinë e shërbimeve në bletari. Suksesi i bletarit është i lidhur ngushtë edhe me sjellje (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, kujdesi, përqendrimi, korrektësia, mospërdorimi i pijeve alkoolike, disiplina etj.; sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e bletërritësit

Profesioni i bletërritësit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës që ndiqen për përgatitjen e shërbimeve në sezonet e pranverës, verës e të vjeshtës, duke zbatuar rregullat dhe teknikat e shërbimit. Bletërritësi mund të punësohet në fermën e tij ose në fermat të tjera që merren me mbarështimin e bletëve. Me përvojë pune dhe kualifikime shtesë bletërritësi mund të përparojë profesionalisht në nivelin e bletërritësit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimet nëpërmjet punës, një bletërritës mund të ndër marrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si bletërritës. Ndjekja e shkollës së lartë çon në diplomimin e specialistëve në këtë profesion. Për të zhvilluar aktivitete private dhe për punësim në veprimtarinë e bletërritësit duhet të bëhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë 6124 – Rritës të bletëve, me kod 6124.01 - Bletërritës, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: bletërritës për përgatitjen e koshereve, bletërritës për përgatitjen e ushqimeve në bletari, bletërritës për përdorimin e medikamenteve në bletari.

II. Kompetencat profesionale që fitojnë kursantët në përfundim të kursit të unifikuar “Shërbime në bletari”

Në përfundim të kursit të unifikuar “Shërbime në bletari” kursantët do të jenë të aftë të:

- Interpretojnë dokumentacionin teknik të punës në bletari.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të shërbimeve që kryhen në bletari.
- Bëjnë organizimin e vogël të punës në bletari.
- Përzgjedhin veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme që përdoren në bletari.
- Kontrollon cilësinë e punimeve të kryera me instrumente përkatëse.
- Zbatojnë rregullat e qëndrimit dhe të lëvizjeve në parkun e bletës gjatë punës.

- Përdorin dhe mirëmbajnë mjetet, pajisjet dhe materialet e punës.
- Kryejnë punime të përgatitjes së zgjoit, të ushqimeve të bletës, si dhe të vendosjes së bletëve në zgjua.
- Kryejnë shërbimet e pranverës dhe të vjeshtës në bletari.
- Kryejnë procese pune të vjeljes së mjaltit, qumështit, polenit, propolisit etj. në bletari.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për shërbimet në bletari.
- Zbatojnë rregullat e higjienës personale dhe mirëmbajtjes së mjedisit të punës.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- Mirëmbajnë veglat e instrumentet dhe sistemojnë ato pas çdo procesi pune.
- Komunikojnë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, kolegët dhe klientët.
- Përdorin burime dhe platforma dixhitale në funksion të veprimtarive të punës në bletari

III. Kërkesat për pranimin e kursantëve në kursin e unifikuar “Shërbime në bletari”

Pjesëmarrësit në kursin e unifikuar të formimit profesional “Shërbime në bletari” duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit të unifikuar për “Shërbime në bletari”

360 orë mësimore, ku 1 orë mësimore = 45 minuta

V. Programi i kursit të unifikuar “Shërbime në bletari”

Nr	Titulli i modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e bletërritësit.	MK-14-303-22	60 orë mësimore Rekomandohet 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të bletërritësit. 2. Kursanti përshkruan bazat e bletarisë. 3. Kursanti përshkruan veglat, pajisjet dhe materialet për shërbimet në bletari. 4. Kursanti përshkruan shërbimet që kryhen në pranverë në bletari. 5. Kursanti përshkruan shërbimet që kryhen në vjeshtë në bletari.
2	Përgatitja dhe vendosja e bletëve në zgjua.	MK-14-304-22	90 orë mësimore Rekomandohet 10% Teori 80% Praktike 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen punë përgatitore për ndërtimin e zgjoit. 2. Kursanti monton zgjoin. 3. Kursanti përgatit zgjoin për vendosjen e bletëve. 4. Kursanti përgatit ushqime për bletën. 5. Kursanti vendos bletën në zgjoin e ri.
3	Kryerja e shërbimeve në bletari	MK-14-305-22	120 orë mësimore Rekomandohet 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësim	1. Kursanti kryen shërbimet e pranverës në bletari. 2. Kursanti kryen shërbimet e vjeshtës në bletari.

4	Vjelja e produkteve në bletari	MK-14-306-22	90 orë mësimore Rekomandohet 10% Teori 80% Praktike 10% Vlerësim	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti kryen vjeljen e qumështit të bletës. 2. Kursanti kryen vjeljen e propolisit. 3. Kursanti kryen vjeljen e mjaltit. 4. Kursanti kryen vjeljen e polenit
---	---------------------------------------	--------------	--	--

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht futen në Provimin përfundimtar teoriko - praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko – praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e moduleve profesionale të kursit të unifikuar “Shërbime në bletari”.

1. Moduli “Hyrje në profesionin e bletërritësit”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodit	HYRJE NË PROFESIONIN E BLETËRRITËSIT	MK-14-303-22
Qëllimi i modulit	Ky modul i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të bletërritësit, me bazat e bletarisë, me veglat, pajisjet, materialet e punës, si dhe me shërbimet kryesore që kryhen në bletari.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet 80% Teori, 10% Praktikë, 10% Vlerësim	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti përshkuan veçoritë e profesionit të bletërritësit Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të përshkruajë legjislacionin në fuqi dhe kodin e punës; – të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së bletërritësit; – të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të bletërritësit; – të përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët; – të përshkruajë rregullat e sigurimi teknik e ruajtjes së mjedisit; – të përshkruajë rregullat e higjienës personale dhe të vendit të punës; – të përshkruajë burimet e rreziqeve në objekt; – të përshkruajë procedurat dhe protokollet standarde të sigurisë sipas rastit të emergjencës (tërmet, përmytje etj.); – të përshkruajë procedurat dhe protokollet standarde të sigurisë në rastet e zjarrit; – të përshkruajë rëndësinë dhe përdorimet e kutisë së ndihmës së shpejtë; – të përshkruajë rregullat e dhënies së ndihmës së shpejtë të lejuar, sipas rastit të aksidentit; – të përshkruajë dokumentacionin teknik dhe financiar që përdoret në shërbimet e bletarisë; – të përshkruajë rëndësinë e organizmit të punës, strukturën organizative dhe komunikimin hierarkik; 	

-
- të përshkruajë mënyrën se si bëhen llogaritje të thjeshta të shërbimeve në bletari (kostot dhe volumi i punës, sasia e materialeve, veglave dhe pajisjeve të punës, çmimi i punimeve etj.).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.

RN 2 Kursanti përshkruan bazat e bletarisë.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë që ka bletaria në zhvillimin e ekonomisë së vendit në përgjithësi, si dhe rëndësinë që ka bleta për bujqësinë në veçanti;
- të përshkruajë vlerat kurative dhe kozmetike që kanë produktet e bletarisë;
të përshkruajë ndërtimin anatomik të bletës, sipas pjesëtarëve të familjes;
- të përshkruajë ciklin biologjik të bletës, sipas pjesëtarëve të familjes (mbretëresha, mashkulli, bleta punëtore);
- të përshkruajë mënyrat e zgjerimit të familjes së bletës (roitje, me ndarje të mbretëreshës);
- të përshkruajë rëndësinë, punët dhe detyrat që ka çdo pjesëtarë në familjen e bletëve, brenda dhe jashtë kosheres;
- të përshkruajë veçoritë dhe karakteristikat e racave të mbretëreshës, si dhe mënyrat e përmirësimit racor të tyre;
- të përshkruajë rëndësinë, karakteristikat dhe llojet e kullotave dhe llojet e mjaltit;
- të përshkruajë mënyrat e shtegtitimit të bletëve, sipas rregullave;
- të përshkruajë rëndësinë dhe teknikat e përgatitjes së ushqimit shtesë për bletën (bugaçe, shurup invert);
- të përshkruajë periudhat për të ushqyer bletën;
- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e territorit për ngritjen e parkut të bletës, bazuar në standardet e mbrojtjes së bletëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit;
- të përshkruajë mënyrën e komunikimit të bletëve jashtë dhe brenda kosheres;
- të përshkruajë mënyrat e vjeljes së produkteve të bletës (mjalti, qumështi, propolis, poleni etj.), si dhe standardet e ruajtjes së tyre;
- të përshkruajë karakteristikat, mënyrat e identifikimit dhe masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve kryesore të bletës;
- të përshkruajë karakteristikat, mënyrat e identifikimit dhe masat mbrojtëse ndaj dëmtuesve kryesore të bletës;
- të përshkruajë masat profilaktike të mbrojtjes së kornizave ndaj dëmtuesve;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.

RN 3 Kursanti përshkruan veglat, pajisjet dhe materialet për shërbimet në bletari.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jete i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe ngjyrat e uniformave të punës në bletari;
- të përshkruajë **materialet bazë** në bletari:
 - përdorimet dhe funksionet e tymëses;
 - përdorimet dhe funksionet e levave hapëse të kosheres;
 - ndërtimin dhe llojet e ndryshme të kosheres/zgjoit;
 - rëndësinë e kutisë me alkool për dezinfektimin e pajisjeve;
- të përshkruajë **materialet ndihmëse** në bletari:
 - llojet dhe përmasat e fletëve të dyllit;
 - funksionin dhe llojin e telit që përdoret në bletari;
 - llojet dhe përdorimet e pincave, çekiçëve, gozhdëve, vidave etj., gjatë kryerjes së shërbimeve në bletari;
 - rëndësinë dhe përdorimin e rripit mbajtës të veglave që përdoren për shërbimet në bletari;
- të përshkruajë bazën materiale që përdoret për vjeljen e **qumështit** të mbretëreshës:
 - kornizat e qumështit;
 - kupat për vendosjen e vezëve;
 - pajisjet për marrjen e larvave;
 - pajisje për largimin e larvave;
 - pajisje për mbledhjen e qumështit;
 - pajisje për vendosjen e qumështit;
 - pajisje për ruajtjen e qumështit (frigorifer);
- të përshkruajë bazën materiale që përdoret për vjeljen e **propolisit**:
 - rrjeta propolisi;
 - pajisje për vendosjen e propolisit;
- të përshkruajë bazën materiale që përdoret për vjeljen e **polenit**:
 - kurthe plastike;
 - centrifugë tharëse;
 - enë për ruajtjen e polenit;
- të përshkruajë bazën materiale që përdoret për vjeljen e **mjaltit**:
 - centrifugë (plastike ose inoks);
 - thikat prerëse dhe furçat;
 - enë kulluese të mjaltit;
 - enë për ruajtjen e mjaltit;
- të përshkruajë bazën materiale që përdoret për vjeljen e **dyllit**:
 - shkrirësja e dyllit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.

RN 4 Kursanti përshkruan shërbimet që kryhen në pranverë në bletari.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet te jete i aftë:

- të përshkruajë kontrollin e rezervave ushqimore në koshere;
- të përshkruajë kontrollin e gjendjes shëndetësore të mbretëreshës;
- të përshkruajë identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në koshere;
- të përshkruajë masat e trajtimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve në koshere;
- të përshkruajë mënyrën e bashkimit të shoqërive të dobëta në parkun e bletëve;
- të përshkruajë mënyrën e zgjerimit me korniza të kosheres;
- të përshkruajë vendosjen e diafragmave për sistemimin e punës së mbretëreshës;
- të përshkruajë vendosjen e kurtheve për mbledhjen e polenit të tepërt në bletët e shëndetshme;
- të përshkruajë procesin e përgatitjes së zgjoit në park për grumbullimin e qumështit;
- të përshkruajë procesin e kontrollit periodik të ecurisë së zgjoit në periudhën kulmore të aktivitetit të mbretëreshës;
- të përshkruajë procesin e vjeljes së produkteve në parkun e bletëve (mjalti, propolis, poleni, qumështi etj.);

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.

RN 5 Kursanti përshkruan shërbimeve që kryhen në vjeshtë në bletari.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë procesin e kontrollit të rezervave ushqimore për dimërim në koshere;
- të përshkruajë procesin e ngushtimit (heqjes) së kornizave të tepërta në koshere;
- të përshkruajë procesin e identifikimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të vjeshtës në koshere ;
- të përshkruajë masat e trajtimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të vjeshtës në koshere;
- të përshkruajë mënyrën e bashkimit të shoqërive të dobëta në parkun e bletëve;
- të përshkruajë procesin e izolimit të koshereve ndaj kushteve atmosferike;
- të përshkruajë procesin e kontrollit të koshereve në park për periudhën e dimërimit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedise reale të punës në parqe bletësh.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me material pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Atyre duhet tu jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit, bazat e bletarisë, veglat, pajisjet dhe materialet që përdoren, si dhe shërbimet kryesore që kryhen në bletari.
- Kursantët duhet të angazhohen edhe në veprimtari të simuluar lidhur me sigurinë në punë dhe dhënien e ndihmës së parë.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat dhe shërbimet që kryhen në bletari.
- Gjate vlerësimit duhet të vihet theksi tek verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale të nevojshme që i duhen bletërritësit.
 - Pajisje dhe mjete pune të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore në bletari të tilla si:
 - uniforma e bletarit,
 - timsja,
 - levat hapëëse,
 - zgjoi,
 - diafragmat,
 - centrifuga,
 - ushqime të ngurta dhe të lëngëta,
 - thika,
 - furçe,
 - fletë dylli,
 - telat dhe materiale të tjera ndihmëse që përdoren në bletari.
 - Skica dhe vizatime teknike të ndryshme.
 - Katalogë, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Përgatitja dhe vendosja e bletëve në zgjua”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	PËRGATITJA DHE VENDOSJA E BLETËVE NË ZGJUA	MK-14-304-22
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson kursantët të kryejnë punime të përgatitjes së zgjoit, përgatitjes së ushqimeve, si dhe të vendosjes së bletëve në zgjoin e ri.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësim	
Niveli parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar me sukses modulën “Hyrje profesionin e bletërritësit”	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	<p>Kursanti kryen punë përgatitore për ndërtimin e zgjoit.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për ndërtimin e zgjoit. – Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës. – Të përzgjedhë materialin bazë drusor për ndërtimin e zgjoit (pisha, ahu etj.). – Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet për ndërtimin e zgjoit. – Të përcaktojë radhën e veprimeve për ndërtimin e zgjoit. – Të përcaktojë kushtet që duhet të plotësojë zgjoit. – Të përzgjedhë bojën për lyerjen e zgjoit. – Të përzgjedhë e llojit të zgjoit për ta ndërtuar (primitiv ose modern). – Të lexojë skicën e ndërtimit të zgjoit sipas llojit të përzgjedhur. – Të përzgjedhë kornizat që do të vendosen në zgjua. – Të përcaktojë numrin e kornizave në zgjua sipas tipit të tij. – Të përzgjedhë telin për ta vendosur në kornizë. – Të përcaktojë dhe të presë gjatësinë e telit për kornizën. – Të përcaktojë mënyrat e shtrëngimit të telit në kornizë. – Të përcaktojë vendin për ndërtimin e zgjoit. – Të transportojë dhe vendos veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për ndërtimin e zgjoit në vendin e punës. – Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm. – Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me ndërtimin e zgjoit. – Të pastrojë vendin e punës, sipas standardit të kërkuar. – Të sterilizojë vendin dhe mjetet e punës. – Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së

mjedisit gjatë kryerjes së kryerjes së pune përgatitore

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
 - Vëzhgim me listë kontrolli.
-

RN 2 Kursanti monton zgjoin.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.
- Të përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e tjera ndihmëse për montimin e zgjoit.
- Të përgatisë vendin e punës për montimin e zgjoit.
- Të përcaktojë radhën e veprimeve për montimin e zgjoit.
- Të montojë dyshtemenë e zgjoit, sipas procedurës së montimit.
- Të montojë pjesët anësore para dhe prapa zgjoit, sipas procedurës së montimit.
- Të montojë tavanin e ushqimit, sipas procedurës së montimit.
- Të montojë çatinë e zgjoit, sipas procedurës së montimit.
- Të montojë dyert e zgjoit, sipas procedurës së montimit.
- Të montojë nënteshat e zgjoit, sipas procedurës së montimit.
- Të realizojë vendosjen e telit në kornizë.
- Të realizojë vendosjen e fletëve të dyllit në kornizë.
- Të kryejë vendosjen e kornizave në koshere.
- Të lyejë nga jashtë zgjoin, me bojë kundër lagështirës.
- Të bëjë kontrollin teknik të punimeve të montimit të zgjoit.
- Të bëjë korrigjimet e duhura në rastet e identifikimit të defekteve gjatë kontrollit teknik të punimeve.
- Të plotësojë dokumentacionin e duhur teknik, sipas rastit.
- Të mbajë saktë shënimet e të gjitha punimeve që kryhen për montimin e zgjoit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të montimit të zgjoit.
- Të pastrojë vendin e punës pas montimit të zgjoit.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet për ndërtimin e zgjoit.
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës gjatë montimit të zgjoit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të zgjoit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti përgatit zgjoin për vendosjen e bletëve.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:



- Të veshë uniformën e duhur në vendin e punës.
- Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.
- Të përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet për përgatitjen e zgjoit.
- Të përgatisë vendin e punës për vendosjen e zgjoit.
- Të përcaktojë radhën e veprimeve për përgatitjen e zgjoit dhe vendosjen e bletëve.
- Të përzgjedhë materialet mbështetëse për vendosjen e zgjoit (profile hekuri, arka të ndryshme etj.).
- Të montojë dyshtemenë e zgjoit, sipas procedurës së montimit.
- Të vendosë zgjojet në park sipas distancave të përcaktuara të zgjoit nga zgjoit dhe të rreshtit nga rreshti.
- Të vendosë zgjoit në pozicion të mbrojtur nga rrymat ajrore.
- Të kryejë sterilizimin e brendshëm të zgjojeve me flakëdhës.
- Të kryejë lyerjen e brendshme të zgjojeve me preparate ushqyese.
- Të bëjë kontrollin teknik të punimeve të përgatitjes së zgjoit për vendosjen e bletëve.
- Të bëjë korrigjimet e duhura në rastet e identifikimit të defekteve gjatë kontrollit teknik të punimeve.
- Të plotësojë dokumentacionin e duhur teknik, sipas rastit.
- Të mbajë saktë shënimet e të gjitha punimeve që kryhen për përgatitjen e zgjoit për vendosjen e bletëve.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të përgatitjes së zgjoit për vendosjen e bletëve.
- Të pastrojë vendin e punës pas përgatitjes së zgjoit për vendosjen e bletëve.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e përgatitjes së zgjoit për vendosjen e bletëve.
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës gjatë.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së zgjoit për vendosjen e bletëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti përgatit ushqime për bletën.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e duhur në vendin e punës.
- Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.
- Të përgatisë veglat dhe pajisjet për përgatitjen e ushqimeve për bletën (brumatriçe, qese plastike, etiketa etj.).

- Të përzgjedhë bazën materiale të nevojshme për përgatitjen e ushqimeve të ngurta dhe të lëngëta për bletën.
- Të përcaktojë radhën e veprimeve për përgatitjen e ushqimeve për bletën.
- Të përgatisë masat e përbërësve për përgatitjen e ushqimeve të ngurta dhe të lëngëta për bletën.
- Të peshojë përbërësit për përgatitjen e ushqimeve të ngurta dhe të lëngëta.
- Të përgatisë ushqime të ngurta për bletën sipas standardit dhe periudhave të ndryshme.
- Të përgatisë ushqime të lëngëta për bletën sipas standardit dhe periudha ve të ndryshme.
- Të hedhë medikamentet e nevojshme për bletën, gjatë përgatitjes së ushqimeve të ngurta dhe të lëngëta.
- Të paketojë ushqimet e përgatitura për bletën.
- Të etiketojë ushqimet e paketuara për bletën.
- Të ruajë ushqimet e ngurta dhe të lëngëta të përgatitura për bletën sipas rregullave të ruajtjes së tyre.
- Të bëjë kontrollin e cilësisë së përgatitjes së ushqimeve të ngurta dhe të lëngëta për bletën.
- Të bëjë përmirësimet e duhura në përgatitjen e ushqimeve sipas rastit.
- Të plotësojë dokumentacionin e duhur, sipas rastit.
- Të mbajë saktë shënimet e të gjitha punimeve që kryhen për përgatitjen e ushqimeve për bletën.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të përgatitjes së ushqimeve për bletën.
- Të pastrojë vendin e punës pas përgatitjes së ushqimeve për bletën.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet për përgatitjen e ushqimeve për bletën.
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës gjatë përgatitjes së ushqimeve për bletën.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së ushqimeve për bletën.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Kursanti vendos bletën në zgjoin e ri.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e duhur në vendin e punës.
- Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.
- Të përgatisë veglat dhe pajisjet për vendosjen e bletëve në zgjua.

- Të përcaktojë radhën e veprimeve për për vendosjen e bletëve në zgjoin e ri.
- Të përcaktojë racën e mbretëreshës për mbarështim.
- Të sigurojë bletët me certifikatë veterinare.
- Të transportojë bletët në park sipas rregullave të përcaktuara.
- Të përgatisë zgjoin e ri për vendosjen e bletëve.
- Të identifikojë mbretëreshën në zgjoin e vjetër.
- Të kalojë mbretëreshën nga zgjoin i vjetër në zgjoin e ri.
- Të kalojë bletët punëtoresh nga zgjoin i vjetër në zgjoin e ri.
- Të vendosë tavanin e ushqimit.
- Të vendosë ushqimin në tavan.
- Të vendosë çatinë mbi zgjoin e ri.
- Të ngushtojë derën e zgjoin në fazën fillestare pas vendosjes së bletëve në zgjoin e ri.
- Të plotësojë dokumentacionin e duhur, sipas rastit.
- Të mbajë saktë shënimet e të gjitha punimeve që kryhen për vendosjen e bletëve në zgjoin e ri.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve për vendosjen e bletëve në zgjoin e ri.
- Të pastrojë vendin e punës pas vendosjes së bletëve në zgjoin e ri.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet për vendosjen e bletës në zgjoin e ri.
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës gjatë vendosjes së bletës në zgjoin e ri.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vendosjes së bletës në zgjoin e ri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedise reale të punës në parqe bletësh.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me material pamore dhe me objekte konkrete, lidhur me përgatitjen e zgjoin të bletëve, përgatitjen e ushqimeve, si dhe për vendosjen e bletëve në zgjua.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Atyre duhet t'u jepen detyra për të kryer punë për përgatitjen e zgjoin, përgatitjen e ushqimeve, si dhe për vendosjen e bletëve në zgjoin e ri.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat e kryera lidhur me përgatitjen e zgjoin, përgatitjen e ushqimeve si dhe vendosjen e bletëve në zgjua.
- Gjatë vlerësimit duhet të vihet theksi tek verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.

-
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale të nevojshme që i duhen bletërritësit.
 - Pajisje dhe mjete pune të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në bletari të tilla si:
 - uniforma e bletarit, lënda drusore,
 - korniza, thika, furçe, flete dylli,
 - telat dhe materiale të tjera ndihmëse që përdoren për montimin e zgjoit, profile hekuri, arka, brumatriçe, qese plastike, etiketa etj..
 - Skica dhe vizatime teknike të ndryshme.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Kryerja e shërbimeve në bletari”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	KRYERJA E SHËRBIMEVE NË BLETARI	MK-14-305-22
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson kursantët të kryejnë shërbime gjatë periudhës së pranverës dhe të vjeshtës në bletari.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore Rekomandohet 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësim	
Niveli parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar me sukses modulën “Hyrje profesionin e bletërritësit”	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursanti kryen shërbimet e pranverës në bletari. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për kryerjen e shërbimeve në bletari gjatë pranverës.– Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet për kryerjen e shërbimeve në pranverë.– Të përcaktojë radhën e veprimeve për shërbimeve të pranverës në bletari.– Të hapë me kujdes pa zhurmë kapakun e zgjoit.– Të tymosë pjesën e sipërme të kornizave të zgjoit.– Të kontrollojë rezervat ushqimore në zgjua.– Të kontrollojë gjendjen shëndetësore të mbretëreshës dhe të bletëve punëtore.– Të kryejë bashkimin e bletëve të dobëta në park, sipas teknikave të ndryshme.– Të kryejë zgjerimin e zgjoit me korniza në katin e parë.– Të vendosë diafragmat për sistemimin e punës së mbretëreshës.– Të kryejë zgjerimin e zgjoit në katet e dyta për magazinimin e mjaltit.– Të identifikojë sëmundjet dhe dëmtuesit e bletëve në zgjua gjatë pranverës.– Të trajtojë sëmundjet dhe dëmtuesit të identifikuar në zgjua.– Të kryejë kontrole periodike gjatë periudhës së pranverës në bletari.– Të bëjë kontrollin e cilësisë së kryerjes së shërbimeve të pranverës në bletari.– Të bëjë korrigjimet e duhura në rastet e identifikimit të defekteve gjatë kontrollit të ushtruar.

-
- Të plotësojë dokumentacionin e duhur teknik, sipas rastit.
 - Të mbajë saktë shënimet e të gjitha shërbimeve që kryhen gjatë pranverës në bletari.
 - Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
 - Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të kryerjes së shërbimeve të pranverës në bletari.
 - Të pastrojë vendin e punës pas kryerjes së çdo shërbimeve të pranverës në bletari.
 - Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet që përdoren për kryerjen e shërbimeve të pranverës në bletari.
 - Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës gjatë kryerjes së shërbimeve të pranverës në bletari.
 - Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të pranverës në bletari.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti kryen shërbimet e vjeshtës në bletari.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për kryerjen e shërbimeve në bletari gjatë vjeshtës.
- Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet për kryerjen e shërbimeve në vjeshtë.
- Të përcaktojë radhën e veprimeve për shërbimeve të vjeshtës në bletari.
- Të hapë me kujdes pa zhurmë kapakun e zgjoit.
- Të tymosë pjesën e sipërme të kornizave të zgjoit.
- Të kontrollojë rezervat ushqimore në zgjua.
- Të kontrollojë gjendjen shëndetësore të mbretëreshës dhe të bletëve punëtore.
- Të kryejë bashkimin e bletëve të dobëta në park, sipas teknikave të ndryshme para dimërimit.
- Të kryejë ngushtimin e zgjoit me heqjen e kornizave të tepërta.
- Të heqë diafragmat për sistemimin e punës së mbretëreshës që janë vendosur në pranverë.
- Të kryejë ngushtimin e zgjoit.
- Të identifikojë sëmundjet dhe dëmtuesit e bletëve në zgjua gjatë vjeshtës.
- Të trajtojë sëmundjet dhe dëmtuesit të identifikuar në zgjua gjatë vjeshtës.
- Të kryejë kontrole periodike gjatë periudhës së vjeshtës

- në bletari.
- Të bëjë kontrollin e cilësisë së kryerjes së shërbimeve të vjeshtës në bletari.
 - Të bëjë korrigjimet e duhura në rastet e identifikimit të defekteve gjatë kontrollit të ushtruar.
 - Të plotësojë dokumentacionin e duhur teknik, sipas rastit.
 - Të mbajë saktë shënimet e të gjitha shërbimeve që kryhen gjatë vjeshtës në bletari.
 - Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
 - Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të kryerjes së shërbimeve të vjeshtës në bletari.
 - Të pastrojë vendin e punës pas kryerjes së çdo shërbimeve të vjeshtës në bletari.
 - Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet që përdoren për kryerjen e shërbimeve të vjeshtës në bletari.
 - Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës gjatë kryerjes së shërbimeve të vjeshtës në bletari.
 - Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të vjeshtës në bletari.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedise reale të punës në parqe bletësh.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me material pamore dhe me objekte konkrete, lidhur me kryerjen e shërbimeve gjatë periudhës së pranverës dhe të vjeshtës në bletari.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Atyre duhet t'u jepen detyra për të kryer punë për kryerjen e shërbimeve gjatë periudhës së pranverës dhe të vjeshtës në bletari.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat e kryera lidhur me kryerjen e shërbimeve gjatë periudhës së pranverës dhe të vjeshtës në bletari.
- Gjatë vlerësimit duhet të vihet theksi tek verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënëtit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale të nevojshme që i duhen bletërritësit.
 - Pajisje dhe mjete pune të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në bletari të tilla si:
 - uniforma e bletarit,
 - korniza, thika, leva, furçe, flete dylli,
 - telat dhe materiale të tjera ndihmëse që përdoren,
 - Skica dhe vizatime teknike të ndryshme.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Vjelja e produkteve në bletari”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	VJELJA E PRODUKTEVE NË BLETARI	MK-14-306-22
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson kursantët të kryejnë punime të vjeljes së produkteve në bletari të tilla si: qumështi i mbretëreshës, propolisi, mjalti, poleni etj.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësim	
Niveli parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar me sukses modulën “Hyrje profesionin e bletërritësit”	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursanti kryen vjeljen e qumështit të bletës. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të veshë uniformën e punës dhe pajisjet mbrojtëse për vjeljen e qumështit të bletës.– Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet për vjeljen e qumështit të mbretëreshës.– Të përcaktojë radhën e veprimeve për vjeljen e qumështit– Të përgatisë kupëzat me dyll për vjeljen e qumështit.– Të vendosë kupëzat e përgatitura në kornizë sipas teknikave përkatëse.– Të vendosë kornizën në zgjoin me bletë.– Të kryejë hapjen e zgjoit të përzgjedhur për marrjen e kornizës me larvë 24 orëshe.– Të identifikojë kornizat pjellë në fazën e larvës së 24 orëve të para, me forma të rregullta.– Të realizojë procesin e marrjes së larvës me anë të mjeteve përkatëse.– Të vendosë larvën 24 orëshe në kupëzat e vendosura në kornizë.– Të vendosë vezët në kupëzat e përgatitura.– Të hapë e zgjoin për vendosjen e kornizës me kupëzat e mbushura me larva për prodhimin e qumështit.– Të vendosë kornizën me kupëzat e mbushura me vezore për krijimin e mbretëreshës.– Të realizojë marrjen e kornizës me larvat e mbretëreshës pas 72 orësh për vjeljen e qumështit.– Të kryejë largimin e larvave nga kupëzat ku ishin vendosur vezoret për krijimin e mbretëreshës.– Të realizojë vjeljen e qumështit me mjetet përkatëse.– Të vendosë qumështin në ambalazhet e përcaktuara .

- Të realizojë ruajtjen e qumështit të mbretëreshës në standardet e përcaktuara.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me procesin e vjeljes së qumështit.
- Të pastrojë vendin e punës, sipas standardit të kërkuar.
- Të sterilizojë vendin dhe mjetet e punës pas vjeljes së qumështit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vjeljes së qumështit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti kryen vjeljen e propolisit.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e duhur në vendin e punës.
- Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.
- Të përgatisë veglat dhe pajisjet për vjeljen e propolisit.
- Të përcaktojë kohën e duhur për grumbullimin e propolisit.
- Të përgatisë mjetet dhe pajisjet për grumbullimin e propolisit.
- Të kryejë vendosjen e kurtheve të propolisit në zgjua.
- Të përcaktojë kohën e largimit të kurtheve të propolisit.
- Të kryejë heqjen e kurtheve të mbushura me propolis nga zgjoi.
- Të kryejë vendosjen e kurtheve të mbushura me propolis në dhoma frigoriferike për një kohë të caktuar.
- Të kryejë shkundjen e rrjetave të propolisit në ambient të pastër.
- Të vendosë rrjetat e propolisit në magazinë.
- Të kryejë grumbullimin dhe ambalazhimin e propolisit.
- Të realizojë ruajtjen e produktit në standardet e përcaktuara.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet, pajisjet pas grumbullimit të propolisit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për vjeljen e propolisit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së vjeljes së propolisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti kryen vjeljen e mjaltit.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e duhur në vendin e punës.
- Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.
- Të përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e tjera ndihmëse për vjeljen e mjaltit.
- Të përgatisë vendin e punës për vjeljen e mjaltit.
- Të identifikojë fazat e pjekurisë së mjaltit në parkun e bletëve.
- Të kryejë hapjen e zgjoit dhe marrjen e kornizave të mjaltit .
- Të realizojë largimin e bletëve në kornizë me anë të mjeteve përkatëse.
- Të transportojë kornizat e mjaltit në vendin e vjeljes.
- Të sistemojë kornizat në magazinë.
- Të vendosë kornizat në pajisjet përkatëse.
- Të realizojë me mjetet përkatëse hapjen e pjesëve të izoluarat të mjaltit në kornizë (thika mjalti me rezistencë).
- Të vendosë kornizat e përgatitura për vjelje në centrifuge (inoks, plastike).
- Të realizojë procesin e centrifugimit (largimin e mjaltit nga korniza).
- Të largojë kornizat e vjela nga centrifuga dhe t'i vendosë ato në vendet e përcaktuara për ruajtje.
- Të realizojë paketimin e mjaltit me ambalazhet e përcaktuara.
- Të vendosë etiketat përkatëse në ambalazhe për llojet e mjaltit (monofiore dhe polifiore).
- Të realizojë ruajtjen e mjaltit sipas standardeve të përcaktuara.
- Të realizojë pastrimin e mjeteve dhe paisjeve pas vjeljes së mjaltit.
- Të pastrojë vendin e punës pas vjeljes së mjaltit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për vjeljen e mjaltit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vjeljes së mjaltit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti kryen vjeljen e polenit.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e duhur në vendin e punës.
- Të respektojë rregullat e higjienës personale dhe në vendin e punës.
- Të përgatisë mjetet dhe pajisjet për grumbullimin e polenit.
- Të për zgjedhë zgjoin për grumbullimin e polenit.
- Të përcaktojë kohën e vendosjes së kurtheve të polenit në zgjua për grumbullimin e tij.
- Të montojë kurthet e polenit në zgjua.

- Të përcaktojë kohën e mbledhjes së polenit nga depozitat e kurtheve.
- Të transportojë polenin nga parku i bletëve në magazinë sipas standardëve.
- Të realizojë largimin e lagështisë së polenit me anë të mjeteve dhe pajisjeve (centrifuga tharëse, termostat).
- Të çmontojë kurthet te polenit nga zgjoi dhe t'i vendosë në magazinë.
- Të përzgjedhë llojin e ambalazhit për vendosjen e polenit (enë qelqi).
- Të etiketojë ambalazhin për produktin e polenit.
- Të realizojë ruajtjen e polenit sipas standardeve të përcaktuara.
- Të përcaktojë kohën e përshtatshme për grumbullimin e polenit (vjeshtë).
- Të përgatisë mjetet dhe pajisjet për grumbullin e polenit.
- Të kryejë vendosjen e kurtheve të polenit në zgjua.
- Të përcaktojë kohën e largimit të kurtheve të polenit.
- Të heqë kurthet e mbushura me polenit nga zgjoi.
- Të vendosë kurthet e mbushura me polenit në dhoma frigoriferike për një kohë të caktuar.
- Të shkundë rrjetat e polenit në ambient të pastër.
- Të vendosë rrjetat e polenit në magazinë.
- Të kryejë grumbullimin dhe ambalazhimin e polenit.
- Të kontrollojë cilësinë e punëve të kryera për vjeljen e polenit.
- Të bëjë korrigjimet e duhura, pas identifikimit të parregullsive gjatë kontrollit të cilësisë.
- Të kujdeset për ruajtjen e produktit sipas standardit të kërkuar.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet, pajisjet pas punës.
- Të pastrojë vendin e punës pas vjeljes së polenit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me proceset e punës për vjeljen e polenit.
- Të plotësojë dokumentacionin e duhur sipas rastit.
- Të mbajë shënime të sakta lidhur me proceset e punës së vjeljes së polenit, të kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vjeljes së polenit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedise reale të punës në parqe bletësh.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore si dhe demonstrime konkrete të veprimeve për vjeljen e qumështit të

-
- bletës, vjeljen e propolisit, vjeljen e mjaltit dhe vjeljen e polenit.
- Kursantëve duhet tu jepen detyra dhe të angazhohen në veprimtari konkrete për vjeljen e qumështit të bletës, vjeljen e propolisit, vjeljen e mjaltit dhe vjeljen e polenit, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
 - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat e kryera.
 - Gjatë vlerësimit duhet te vihet theksi tek verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore dhe park bletësh.
 - Pajisje dhe mjete pune të domosdoshme për vjeljen e prodhimeve të bletarisë:
 - kupëza dhe korniza,
 - mjete për marrjen e larvës,
 - ambalazhe qumështi,
 - mjete sterilizuese,
 - kurthe dhe rrjeta propolisi.
 - dhoma frigoriferike,
 - ambalazhe propolisi,
 - korniza mjalti,
 - thika mjalti,
 - centrifuga,
 - ambalazhe dhe etiketa mjalti,
 - kurthe poleni,
 - ambalazhe dhe etiketa poleni.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-